

BASHKËBISEDIM ME MINISTREN PËR RININË DHE FËMIJËT, Z.NJ. BORA MUZHAQI RINIA PËR RININË



Studentët e UE-së diskutuan shumë çështje gjatë këtij takimi. I artikuluan qartë dhe në mënyrë koncize të gjithë problemet që prekin të rinjtë sot.



Studentët evidentuan nevojën për një orientim më të mirë të tregut të punës. Ata kërkuar më shumë mundësi argëtimi për t'u larguar ngaveset dhe më shumë hapësira për të zhvilluar talentet e tyre.



Një çështje me shumë rëndësi e diskutuar gjatë takimit ishte kujdesi për shëndetin mendor të të rinjve, si dhe domosdoshmëria e ngritjes së qendrave të ndryshme për trajtimin e këtyre problemeve.

U diskutua për më shumë mundësi punësimi për të rinjtë pa eksperiencë dhe për më shumë praktika të ndryshme pune.



■ Ndër bisedat vizionare që u shtruan, ishte edhe nevoja për të përfshirë gjuhën shqipe si lëndë në çdo program studimi në universitet, për një brez që flet dhe shkruan saktë gjuhën tonë apo edhe nevojën për redaktorë në të gjitha institucionet publike.



Rinia është e tashmja dhe e ardhmja!